



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

RAPORTI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT PËR KOSOVËN QË NGA PAVARËSIMI

SHKURT 2008 – QERSHOR 2017



Autor:

Shpend Kursani

Hulumtuesit:

Skender Perteshi

Vesë Kelmendi

Recensues:

Florian Qehaja

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Të drejtat e pronës intelektuale janë të mbrojtura me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.



Kingdom of the Netherlands

Ky projekt u përkrah përmes Ambasadës Holandeze në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës Holandeze në Kosovë.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

RAPORTI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT PËR KOSOVËN QË NGA PAVARËSIMI

SHKURT 2008 – QERSHOR 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	8
2. METODOLOGJIA	11
3. PËRMBLEDHJE E INCIDENTEVE TË KËRCËNIMIT	15
4. BESUESHMËRIA E KËRCËNIMEVE	20
5. PASOJAT	27
6. KËRCËNIMET LIDHUR ME LUFTËTARËT E HUAJ	33
7. PËRFUNDIM	35

FIGURAT, TABELAT DHE HARTAT

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Lloje kërcënimesh lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	16
Figura 2: Fushëveprimi i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	17
Figura 3: Statusi i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	21
Figura 4: Statusi i detajuar i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	21
Figura 5: Statusi dhe fushëveprimtaria e llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	23
Figura 6: Statusi dhe fushëveprimtaria e detajuar e llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	23
Figura 7: Viktimat në kërcënimet lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	28
Figura 8: Viktimat sipas fushëveprimit të kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	29
Figura 9: Numri i viktimave sipas fushëveprimit të kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017)	30
Figura 10: Caqet e kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=88	32
Figura 11: Numri i LH të përfshirë në kërcënimin lidhur me Kosovën (2008-2017), N=117	33
Figura 12: Numri i kërcënimeve të LH lidhur me Kosovën (2008-2017), N=71	34

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Ranglista e vendeve bazuar në databazën e Indeksit Global të Terrorizmit (Global Terrorism Index - GTI)	19
Tabela 2: Numri mesatar i viktimave të kërcënimit total lidhur me Kosovën, përgjatë viteve 2008-2017	30
Tabela 3: Numri mesatar i viktimave që u shkaktuan nga kërcënimet lidhur me Kosovën përgjatë viteve 2008-2017	31

LISTA E HARTAVE

Harta 1: Lloji dhe statusi i kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73	24
Harta 2: Evropa dhe Lindja e Mesme, N=70	25
Harta 3: Amerika Veriore, N=2	25
Harta 4: Azia Juglindore, N=1	26

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Duke ndjekur një qasje të vlerësimit të rrezikut që i përshtatet më së miri kontekstit të Kosovës, QKSS ka krijuar një databazë për incidentet e kërcënimeve, që mbulon periudhën prej pothuajse një dekade, domethënë ndërmjet shkurtit 2008 dhe qershorit 2017. Është e qartë se që nga lindja e konfliktit sirian dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj, incidentet e kërcënimeve fetare janë rritur paksa krahasuar me vitet e kaluara. Megjithatë, gjetjet e këtij vlerësimi sugjerojnë se incidentet e kërcënimit politik vazhdojnë të kenë hisen më të madhe të përqindjes sesa të gjitha incidentet të kërcënimit në Kosovë në dekadën e fundit. Nga 73 incidentet e regjistruara të kërcënimeve në databazën e QKSS-së, shumica ose afër 62 për qind, ishin politike, ndërsa rreth 36 për qind ishin të natyrës fetare. Po ashtu, vlerësimi tregon se normat e ekzekutimit në mesin e të gjitha kërcënimeve të regjistruara (kërcënimet që shkuan përtej paralajmërimeve verbale ose ato që nuk ishin parandaluar nga autoritetet), ishin shumë më të larta në llojin politik të kërcënimeve, sesa në atë fetar. Afro 80 për qind e kërcënimeve të ekzekutuara ishin të natyrës politike, ndërkohë që afro 70 për qind e kërcënimeve të paekzekutuara ishin të natyrës fetare.

Nga të gjitha kërcënimet e regjistruara, pothuajse të gjitha, ose afër 93 për qind të incidenteve të kërcënimeve politike ishin të përqëndruara brenda vendit, ndërsa më shumë se gjysma e incidenteve të kërcënimit fetar, ose 58 për qind e tyre, ishin të përqëndruara jashtë vendit. Është interesante të vihet në dukje se këto incidente të kërcënimeve fetare me fushëveprim ndërkombëtar, mund të grupohen më tej në dy kategori, domethënë në ato që u regjistruan në hemisferën perëndimore të botës nga njëra anë dhe ato që u regjistruan në Lindjen e Mesme – karakteristike për fenomenin e luftëtarëve të huaj – nga ana tjetër. Incidentet e kërcënimit të regjistruara në Perëndim, zakonisht përfshijnë individë që kanë të bejnë disi me Kosovën, por që nuk janë të lidhur fort me të; ata zakonisht përfaqësojnë brezin e ri të migrantëve që e kanë lënë Kosovën në moshën e hershme me prindërit e vet gjatë konflikteve të viteve 1990 ose kanë lindur në ndonjërin nga vendet perëndimore.

Kur flitet për pasojat e secilit prej kërcënimeve të regjistruara, databaza jonë e incidenteve të kërcënimeve tregon se shumica e kërcënimeve ishin jovdekjeprurëse. Më se 70 për qind e të gjitha incidenteve të regjistruara në dekadën e fundit nuk kanë rezultuar me viktima - as vdekje e as lëndime. Vetëm rreth 16 për qind e incidenteve të kërcënimit gjatë dekadës së fundit rezultuan me vdekje, ndërsa më shumë se 10 për qind rezultuan me lëndime. Është gjithashtu interesante të theksohet se në aspektin e pasojave të incidenteve të kërcënimit, ekziston një marrëdhënie e përkundërt midis llojeve politike dhe fetare të incidenteve të kërcënimit. Më se 65 për qind e incidenteve të kërcënimit që rezultuan me vdekje (ose gjithsej 8 prej tyre), ishin të natyrës politike,

ndërsa të tjerat, ose gjithsej 4 incidente kërcënimi në dekadën e fundit ishin të natyrës fetare. Nga këto 4 incidente të kërcënimeve fetare, që rezultuan me vdekje, asnjëri nuk ishte i fushëveprimit të brendshëm, pra asnjëri nuk ndodhi brenda territorit të Kosovës. Nga pikëpamja statistikore, numri i viktimave, në aspektin e vdekjeve a të lëndimeve, mbetet jo substancial. Kur shqyrton numrin mesatar të viktimave kundrejt numrit të përgjithshëm të kërcënimeve, bëhet e qartë se ka pasur 1 vdekje dhe 1 lëndim për çdo shtatë vjet.

Lidhja ndërmjet luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë dhe kërcënimeve mbetet shumë e dobët. Nga rreth 117 luftëtarë të huaj të kthyer, 5 janë përfshirë në kërcënime, të cilat kurrë nuk u ekzekutuan. Numri i përgjithshëm i kërcënimeve në të cilat u përfshinë këta pesë individë është 3 nga 73 incidentet e regjistruara të kërcënimeve. Analiza e incidenteve të kërcënimeve në Kosovë dhe prej saj gjatë dekadës së fundit sugjeron që rreziqet kanë qenë relativisht të ulëta, si në aspektin e fushëveprimit ashtu edhe në atë të pasojave. QKSS-ja, sidoqoftë, nuk ndërmerr ndonjë pretendim parashikues lidhur me përfshirjet e ardhshme të mundshme, pasi që ekzistojnë shumë pak informata, për shembull, sa u përket luftëtarëve të huaj të kthyer dhe të dënuar, lidhjes së tyre me vendime të tilla, sjelljes që tregojnë brenda burgjeve, si dhe efekteve të mundshme që këto gjëra mund të kenë pasur mbi ta në lidhje me shtetin, institucionet e tij dhe shoqërinë në përgjithësi.

1. HYRJE

Raporte të ndryshme thonë se mes viteve 2012 dhe 2017, rreth 315 qytetarë të Kosovës kanë udhëtuar në zona konflikti në Siri dhe Irak.¹ Prej tyre, më se një e treta tashmë janë kthyer në Kosovë. Një e treta tjetër besohet të jetë ende në zonat e konfliktit, duke përfshirë dhjetëra joluftëtarë, ndër të cilët ka shumë gra dhe fëmijë, ndërsa rreth 60 individë besohet se kanë humbur jetën.² Numri i më se 110 të kthyerve dhe një numër i ngjashëm i të kthyerve potencialë paraqesin shqetësime rreth rreziqeve të mundshme që bartin për sigurinë dhe liritë individuale e kolektive në Kosovë e më gjerë. Sipas Barometrit të Sigurisë së Kosovës (BSK) për vitin 2016, 75 për qind e qytetarëve të Kosovës i perceptojnë luftëtarët e huaj të kthyer si kërcënim, ndërsa më shumë se 50 për qind nuk do t'i praninin të kthyerit brenda komunitetit të tyre.³

Kërcënimi i mundshëm nga shfaqja e fenomenit të paprecedent të luftëtarëve të huaj midis disa qytetarëve të Kosovës është spekuluar gjerësisht nëpër raporte dhe media të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Mjetet e ndryshme të informimit, nga ato në Shtetet të Bashkuara (SHBA) si *The New York Times* që përshkruan Kosovën si një "tokë pjellore për ISIS" dhe një "tubacion për xhihadistët", deri te *L'Espresso* italiane, që pohonte se luftëtari i huaj famëkeq, me origjinë nga Kosova, Lavdrim Muhaxheri, ishte gati të kthehej në Kosovë me 300-400 luftëtarë nga Kalifati, duke supozuar nivelet e kërcënimeve me tonalitete të ndryshme.⁴ Ndërkohë që mediat të cilat raportojnë mbi çështjen në fjalë mund të minimizohen si joprofesionale ose jo mjaft analitike, ato

1 Viti 2017 në vijim i referohet periudhës janar-qershor 2017.

2 Këto janë vlerësimet më të fundit të përafërta sipas raporteve të ndryshme, d.m.th: Rita Augestad Knudsen, "Radikalizimi dhe luftëtarët e huaj në kontekstin e Kosovës: Analizë e mbulimit të fenomenit nga media ndërkombëtare," Punim paraprak (Oslo, Norvegji: Instituti i Norvegjisë për Çështje Ndërkombëtare, 2017), /en/Publications/CRISStin-Pub/Radicalization-and-foreign-fighters-in-the-Kosovo-context-An-analysis-of-international-media-coverage-of-the-phenomena; Leonora Aliu, "Të Zgjedhësh Mes Qytetit Tënd Dhe Shtetit Islamik," *Kosovo 2.0* (blog), 17 tetor, 2017, <http://kosovotwopointzero.com/choosing-city-islamic-state/>.

3 Vesë Kelmendi, "Qëndrimet e qytetarëve kundër ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm në Kosovë," Barometri i Sigurisë së Kosovës (Prishtinë, Kosovë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 13 qershor 2016), <http://www.qkss.org/en/Reports/The-citizens-views-against-violent-extremism-and-radicalization-in-Kosovo-710>; Florian Qehaja, Skender Perteshi, dhe Mentor Vrajolli, "Paraqitja e gjendjes në lidhje me përfshirjen institucionale dhe komunitare në kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë" (Prishtinë, Kosovë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Network for Religious and Traditional Peacemakers, 13 shkurt 2017), <http://www.qkss.org/en/Reports/Mapping-the-state-of-play-of-institutional-and-community-involvement-in-countering-violent-extremism-in-Kosovo-864>.

4 Carlotta Gall, "Si u kthye Kosova në truall pjellor për ISIS," *The New York Times*, 21 maj 2016, <http://www.nytimes.com/2016/05/22/world/europe/how-the-saudis-turned-kosovo-into-fertile-ground-for-isis.html>; Marco Pacini, "Il Ritorno Del Boia Dei Balcani," *L'Espresso*, December 26, 2016, <http://espresso.repubblica.it/attualita/2016/12/22/news/il-ritorno-del-boia-dei-balcani-1.291989>.

megjithatë kanë një aftësi të madhe për të formësuar opinionin publik dhe perceptimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke ndikuar - në shkallë të ndryshme - edhe në hartimin e politikave.⁵

Qendra Ndërkombëtare për Kundërterrorizëm në Hagë (ICCT), vuri në dukje se fenomeni i luftëtarëve të huaj paraqet një “rrezik serioz të sigurisë” për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe shoqëritë e tyre në nivelet e tyre kombëtare.⁶ Që nga viti 2011 kur filloi konflikti sirian dhe luftëtarët e huaj dolën në pah, një numër shtetesh anëtare të BE-së i kanë ngritur nivelet e vlerësimit të kërcënimeve në më të lartat.⁷ Megjithatë, në lidhje me Kosovën, një ekip nga USAID-i bëri një vlerësim të rrezikut të ekstremizmit të dhunshëm në prill-maj të vitit 2015, duke vënë në dukje se “rreziku në Kosovë nga ekstremizmi i dhunshëm mbetet shumë i ulët”⁸. Sipas USAID-it, disa nga arsyet për rrezikun e ulët, ndër të tjera, përfshijnë pikëpamjet e përgjithshme në Kosovë rreth reagimit të Qeverisë ndaj çështjes, e cila është vërejtur të jetë “e matur, e balancuar dhe përgjithësisht e parë pozitivisht”⁹. Po ashtu, vlerësimi i USAID-it ka theksuar pikëpamjet e respondentëve se ekstremizmi i dhunshëm është “kërcënim potencialisht ekzistues në një periudhë afatgjatë [...] duke hedhur dritë mbi depërtimin e fesë si një parim udhëzues në një shoqëri fundamentalisht sekulare”¹⁰.

Megjithatë, një numër ngjarjesh të lidhura me luftëtarët e huaj dolën në shesh që nga botimi raportit të fundit të vlerësimit të rrezikut nga USAID-i mbi Kosovën. Në korrik të vitit 2015, organet e sigurisë në Kosovë arrestuan pesë persona pranë liqenit të Badovcit, për të cilët mediat pretenduan se po përpiqeshin të helmonin liqenin - një nga burimet kryesore të ujit për kryeqytetin.¹¹ Akuzat për tentim helmimi të ujit u hoqën më pas, edhe pse të dyshuarit vazhduan të mbahen në paraburgim për akuza të tjera terrorizmi.¹² Disa muaj më vonë, me kërkesë të Qeverisë së ShBA, autoritetet

5 Augustad Knudsen, “Radikalizimi dhe luftëtarët e huaj në kontekstin e Kosovës.”

6 Bibi van Ginke dhe Eva Entenmann, “Fenomeni i luftëtarëve të huaj në Bashkimin Evropian: Profilet, Kërcënimet & Politikat,” Raport Hulumtues (Qendra Institucionale për Kundër-Terrorizëm, Hagë, prill 2016), http://icct.nl/wp-content/uploads/2016/03/ICCT-Report_Foreign-Fighters-Phenomenon-in-the-EU_1-April-2016_including-AnnexesLinks.pdf.

7 van Ginke dhe Entenmann.

8 USAID, “Vlerësimi i rrezikut nga Ekstremizmi i dhunshëm, Kosovë: prill-maj 2015,” Raport (USAID, 2015), http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00M3P6.pdf.

9 USAID.

10 USAID.

11 The Guardian, “Kosovë, ndalet furnizimi me ujë pas pretendimeve për helmim të liqenit,” *The Guardian*, 11 korrik 2015, sec. World news, <http://www.theguardian.com/world/2015/jul/11/kosovo-cuts-pristina-water-supply-over-alleged-isis-plot-to-poison-reservoir>.

12 Kreshnik Gashi dhe Labinot Leposhtica, “Kosovë, hiqet helmimi nga akuzat për terrorizëm,” *Balkan Insight*, 11 dhjetor 2015, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-prosecution-finds-no-proof-of-isis-poisoning-the-lake-12-11-2015> Sipas bisedimeve joformale me përfaqësuesit e Drejtorisë së Anti-Terrorizmit në Policinë e Kosovës, përpjekja e supozuar e helmimit të liqenit ishte diçka që ata dëgjuan vetëm nga media dhe se kishin dyshime të tjera sa u përket personave të arrestuar.

malajziane arrestuan Ardit Ferizin, një haker kompjuterik 20 vjeçar nga Kosova, i cili dyshohej se i kishte siguruar Daesh-it (ISIS-it) të dhënat personale të më shumë se 1,000 punonjësve të qeverisë amerikane.¹³ Po ashtu, në nëntor 2016, organet e sigurisë të Kosovës arrestuan më shumë se një dyzinë individësh të dyshuar për planifikimin e sulmeve të njëkohshme terroriste në Kosovë dhe Shqipëri, ku do të zhvillohej ndeshja kualifikuese e Kupës Botërore 2018, midis Shqipërisë dhe Izraelit.¹⁴ Po ashtu së fundmi, në prill 2017, Këshilli i Sigurisë i Kosovës lëshoi një deklaratë duke paralajmëruar publikun për atë që duket të jetë një kërcënim i paqartë kundër “rendit kushtetues”, dhe kundër disa prej “liderëve institucionalë dhe politikë të Kosovës” të Kosovës, me synim “destabilizimin e Kosovës”.¹⁵ Sipas deklaratës, këto akte ishin planifikuar të kryheshin prej “disa individëve dhe grupeve të tyre, të lidhura me grupe dhe individë nga vende tjera jashtë Kosovës”, dhe janë të lidhura me “njerëz me të kaluar të dyshimtë, që punojnë me grupe dhe shërbime të disa vendeve dhe mund të kenë lidhje me persona të inkriminuar në konflikte jashtë Kosovës, si dhe me vende të caktuara [sic.]” që synojnë destabilizimin e Kosovës.¹⁶ Kësisoj, Këshilli i Sigurisë i Kosovës vuri në dukje si aktorët shtetërorë, ashtu edhe ata jo-shtetërorë, si adresa të mundshme, nga ku mund të kenë buruar këto kërcënime.

Mbi këtë bazë, QKSS ka kryer një vlerësim të rrezikut të kërcënimeve të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës, që prej shpalljes së pavarësisë së saj në shkurt 2008 e deri në qershor 2017. Ndonëse ky raport nuk ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse mbi analizën e rrezikut, ai u qaset kërcënimeve në mënyrë më gjithëpërfshirëse, gjë të cilën do ta diskutojmë në seksionin vijues mbi metodologjinë. Pas seksionit metodologjik, raporti vazhdon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të kërcënimeve lidhur me Kosovën, ku paraqiten llojet e përgjithshme dhe fushëveprimi i kërcënimeve. Pasqyra pastaj ndiqet nga seksioni mbi besueshmërinë e kërcënimeve, ku diskutohet një vlerësim më i hollësishëm i seriozitetit, sipas llojit dhe fushëveprimit. Pas kësaj, vlerësimi vazhdon me pasojat e këtyre kërcënimeve dhe paraqet disa informacione mbi viktimat dhe caqet e kërcënimit në dekadën e fundit. Në fund, vlerësimi paraqet marrëdhëniet e luftëtarëve të huaj me sfondin e llojeve të ndryshme dhe fushëveprimin e kërcënimeve të lidhura me Kosovën.

13 SHBA, Departamenti i Shtetit, “Raportet e vendit mbi terrorizmin, 2015” (Washington, D.C.: United States Department of State, 2 qershor 2016), <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2015/index.htm>.

14 Policia e Kosovës, “Policia e Kosovës Arrin Rezultate Pozitive Në Parandalimin Dhe Arrestimin e Personave Të Dyshuar Për Terrorizëm,” 16 nëntor 2016, <http://www.kosovopolice.com/sq/informacione/policia-e-kosoves-arrin-rezultate-pozitive-ne-parandalimin-dhe-arrestimin-e-personave-te-dyshuar-per-terrorizem>.

15 Zyra e Kryeministrit të Kosovës, “Komunikatë për shtyp,” 14 prill 2017, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,6726>.

16 Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

2. METODOLOGJIA

Nuk ekziston një qasje e vetme për t'i vlerësuar rreziqet e akteve të mundshme të terrorizmit, pasi kjo përfshin pasiguri të mëdha dhe kërkon një trajtim të thellë të çdo incidenti të vetëm kërcënimi që ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur nën kushte të caktuara. Një mënyrë për të bërë vlerësimin e nivelit të kërcënimeve në Kosovë është përdorimi i qasjeve tashmë të vendosura që shqyrtojnë karakteristikat e nivelit individual të ish luftëtarëve të huaj ose atyre të dyshuar për përfshirje në ndonjë incident të kërcënimeve të kaluara për të nxjerrë përfundime parashikuese për sjelljen e tyre të ardhshme.¹⁷ Derisa qasjet e tilla individuale kanë shumë përparësi, është e pamundshme t'i përdorim ato në vlerësimin tonë të tanishëm, sepse duhet të mbështetemi në informacione dhe histori personale të thella në lidhje me zhvillimin ideologjik të secilit individ, sfondin psikologjik, sfondin familjar dhe social, zhvillimet e personalitetit - informacione që, përveç disa karakteristikave të përgjithshme personale, nuk janë të disponueshme për asnjë nga të dyshuarit e bazuar në Kosovë.

Mënyrë tjetër për të bërë vlerësimin e nivelit të kërcënimit në Kosovë është përfshirja në nivel strukturor të incidenteve të kërcënimit në të kaluarën, në aspektin e llojit të kërcënimit, caqeve të përfshira, cenueshmërive dhe pasojave të kërcënimeve. Një qasje e tillë është propozuar nga Qendra RAND për Politikën e Menaxhimit të Rrezikut të Terrorizmit, e cila e sheh terrorizmin si një rrezik me tre përbërës: "kërcënimi ndaj një caku, cenueshmëria e caktit ndaj kërcënimit dhe pasojat nëse caku sulmohet me sukses".¹⁸ Propozimi i vlerësimit të rrezikut nga terrorizmi i RAND-it është parashikues nga karakteri, me ç'rast indikatorët derivojnë nga të tre elementët, të cilët pastaj përdoren për të bërë pretendime probabilitare për një rrezik të mundshëm që lind nga një sulm specifik, i një lloji të caktuar me disa dëme të pritshme të një lloji të caktuar në të ardhmen. Për shembull, në propozimin e RAND-it:

- *kërcënimi* definohet si "probabiliteti që një cak specifik të sulmohet në një mënyrë specifike gjatë një periudhe kohore të caktuar";
- *cenueshmëria* definohet si "probabiliteti që dëmet të ndodhin (dëmet mund të përfshijnë vdekje, lëndime, dëmtim të pronës ose pasoja të tjera), duke pasur parasysh një lloj të veçantë të sulmit, në një kohë të caktuar, në një cak të caktuar"; dhe

17 Karl Roberts dhe John Horgan, "Vlerësimi i rrezikut dhe terroristi," *Perspektivat mbi Terrorizmin* 2, nr. 6 (2008), <http://www.terrorismanalysts.com/pt/index.php/pot/article/view/38>; Bart Schuurman dhe Quirine Eijkman, "Indikatorët e qëllimeve dhe mundësive terroriste: Mjetet për Vlerësimin e kërcënimit," *Dinamikat e Konfliktit Asimetrik* 8, nr. 3 (2 shtator 2015): 215–31, <https://doi.org/10.1080/17467586.2015.1040426>.

18 Henry H. Willis et al., "Vlerësimi i rrezikut nga terrorizmi," Product Page (RAND Center for Terrorism Risk Management Policy, 2005), <https://www.rand.org/pubs/monographs/MG388.html>. Origjinali është në gjuhën angleze.

- *pasoja* definohet si “madhësia e dëmit (p.sh., vdekjet, lëndimet ose dëmtimi i pronës), duke pasur parasysh një lloj të veçantë të sulmit, në një kohë të caktuar, që rezulton në dëmtimin e një caku specifik”.¹⁹

QKSS bazon kërcënimin e vlerësimit të rrezikut kryesisht në elementet e zhvilluara nga RAND, me disa modifikime. Së pari, qasja e QKSS nuk do të jetë parashikuese; kjo për shkak se numri i kërcënimeve totale të identifikuara për qëllimet e vlerësimit të tanishëm është shumë më i ulët sesa që çdo studim parashikues e lejon për ta bërë çfarëdo pretendimi parashikues statistiki ose substancialisht të rëndësishëm. Së dyti, qasja e QKSS është historike dhe kontekstuale, duke analizuar ngjarjet e fundit të rrezikut ndaj kontekstit të brendshëm dhe ndërkombëtar, prej të cilit rrjedh një pjesë e analizës - jo parashikimet. Për të mbështetur këtë qasje, ekipi i hulumtuesve të QKSS ka zhvilluar një databazë për incidentet e kërcënimeve që përfshin të gjitha ngjarjet kërcënuese që nga shkurti 2008 deri në qershor 2017. Arsyetimi prapa këtij aspekti dhjetëvjeçar, të përkohshëm të studimit është baza jonë për të përdorur muajin e pavarësisë së Kosovës si pikënisje dhe muajin e këtij viti kur ky raport është përpiluar si pikë përfundimtare e analizës. Databaza është komponenta kryesore e këtij vlerësimi të rrezikut dhe me publikimin e këtij raporti, QKSS vë databazën e saj në dispozicion publik për qëllime të vlefshimit të jashtëm.²⁰ Së treti, ne besojmë se për të kuptuar më mirë nivelin e rrezikut terrorist apo rreziqet që përfshijnë luftëtarët e huaj me origjinë kosovare, një krahasim i llojeve të kryqëzuara të kërcënimit do të sigurojë ndjesinë e duhur kontekstuale të studimit. Kjo për faktin se për të qenë në gjendje të thuash nëse ekziston një rrezik i ultë apo i lartë ose diçka ndërmjet, nënkupton domosdoshmërisht një krahasim - dmth. më i ultë në krahasim me çka, ose më i lartë në krahasim me çka? Prandaj, pas studimit të databazës sonë, pjesa më e madhe e analizës së paraqitur këtu është një krahasim midis dy llojeve të kërcënimeve: kërcënimet fetare dhe politike. Një aspekt tjetër krahasimor që prezentojmë për të bërë vlerësimin tonë kontekstualisht të ndjeshëm, është që të përfshijmë një vlerësim ndërshtetëror të indeksit të terrorizmit, në mënyrë që të mund të shohim se ku qëndron Kosova në treguesë të tillë (që të tjerët i kanë krijuar), krahasuar me vendet e tjera, relevante për këtë analizë.

Para se të vazhdohet me analizën e vërtetë, janë të nevojshme disa fjalë për mbledhjen e të dhënave për incidentet e kërcënimeve në Kosovë. Elementi thelbësor për regjistrimin e ngjarjeve kërcënuese që kanë ndodhur gjatë periudhës së vlerësimit të tanishëm, përfshin miratimin e një përkufizimi të “terrorizmit”, “kërcënimit të terrorizmit” ose “rrezikut të terrorizmit” apo thjesht “kërcënimet” ose “incidentet e kërcënimit”. Aktualisht ka më shumë se disa qindra përkufizime të terrorizmit. Në këtë aspekt, QKSS nuk synon të japë përkufizimin e vet të terrorizmit përbrenda shumëllo-

¹⁹ Willis et al.

²⁰ Nëse llexuesit kanë vështirësi në gjetjen ose marrjen e databazës online, ata duhet të dërgojnë një kërkesë për të marrë databazën ose tek autori i këtij raporti ose në QKSS.

jshmerisë së përkufizimeve të ofruara tashmë nga agjencitë qeveritare, studiuesit dhe organizatat. Zgjedhja e një përkufizimi ekzistues të punës mbi një tjetër ose dhënia e një përkufizimi të ri, megjithatë, kërkon një arsyetim të një vendimi përfundimtar, dhe kësaj domosdoshmërisht përfshin edhe gjykimet mbi vlerat. QKSS është e vetëdijshme se çdo vendim mund të kënaqë disa, dhe t'i shqetësojë të tjerët. Megjithatë, ne theksojmë faktin se asnjë nga përkufizimet në dispozicion nuk është e kënaqshme për kontekstin e Kosovës; kjo ndodh për shkak se shumica e këtyre përkufizimeve e konsiderojnë terrorizmin si akt të dhunshëm që vetëm se është ndërmarrë dhe jo kërcënim për përdorimin e dhunës. Sigurisht, disa të tjerë përfshijnë elemente të tilla, por nëse duam të heqim dorë nga kërcënimet e përdorimit të dhunës dhe të përfshijmë vetëm veprimet e dhunshme që vetëm se kanë ndodhur, atëherë do të mbetet shumë pak për të folur në lidhje me kërcënimet e terrorizmit në Kosovë, pasi që nuk ka pasur shumë (nëse ka pasur) akte të mëdha dhune të zbatuara brenda vendit, veçanërisht aso që përfshijnë luftëtarë të huaj.

QKSS beson se është e arsyeshme të përfitojë nga dy përkufizime të terrorizmit të cilat mbivendosen në shumicën etributeve të tyre definitive, ndërkohë që janë ekskluzive për disatribute të tjera – gjë që e vërejmë. Të shikojmë së pari përkufizimin e terrorizmit të parashikuar në Kodin Penal të Kosovës. Neni 135 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës e përkufizon terrorizmin si:

... kryerja e një ose më shumë veprave penale [...] me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare [...].²¹

Përkufizimi i dhënë nga Kodi Penal i Kosovës është vështirë të operacionalizohet me qëllim identifikimin e kërcënimeve të mundshme që meritojnë të përfshihen në databazën tonë, edhe pse ne e shfrytëzojmë si një pikënisje. Për të anashkaluar problemin e operacionalizimit të përkufizimit të sipërpërmendur, regjistrujmë kërcënime që janë sa më afër përkufizimit të dhënë edhe nga Databaza e Terrorizmit Global (GTD), e cila e definon terrorizmin si “kërcënim për të përdorur forcën dhe dhunën ilegale apo edhe ai aktual, nga një aktor joshtetëror, për të arritur një qëllim politik, ekonomik, fetar ose

21 Kuvendi i Republikës së Kosovës, “Kodi Penal i Republikës së Kosovës,” Pub. L. Nr. 04/L-082, § Neni 135, 63 (2012), <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,914> - i cili, po ashtu, ofron listën e akteve që konsiderohen si akte terrorizmi.

social nëpërmjet frikës, shtrëngimit ose frikësimit”.²² Përkufizimi i GTD përcakton më tej, duke sqaruar se për t’u regjistruar në databazë:

- Incidenti duhet të jetë i qëllimshëm
- Incidenti duhet të ngërthejë njëfarë niveli të dhunës ose kërcënimin e menjëhershëm të dhunës
- Autorët e incidenteve duhet të jenë aktorë joshtetërorë ²³

Prandaj këto janë dy përkufizimet të cilat ekipi i QKSS i përdorë si instrumente orientuese, në identifikimin e kërcënimeve që meritojnë një vend në databazën e QKSS për kërcënimet.

Së fundi, të dhënat mbi kërcënimet midis shkurtit 2008 dhe qershorit 2017 u mbledhën nga një kombinim burimesh. Për të filluar dhe për qëllime të konsistencës, si pikënisje kemi marrë kërcënimet e regjistruara në databazën e GTD-së, duke qenë se GTD është një nga databazat më të plota që regjistron incidente terroriste në mbarë botën që nga viti 1970, si një projekt bashkëpunues i një numri universitetesh dhe organizatash.²⁴ Ndonëse kjo ishte një pikë e mirë fillestare, na është dashur të modifikonim databazën e GTD-së në dy aspekte. Bëmë modifikime të vogla në disa nga incidentet që GTD ka regjistruar. Për shembull, GTD kishte regjistruar vrasjen e një prej kandidatëve të PDK-së për deputet, Elvis Pista, në Rahovec në vitin 2014, si një incident terrorist. Ne e kemi larguar këtë dhe ngjarje të tjera të ngjashme të regjistruara nga GTD, pasi që këto lloje të incidenteve nuk mund të mbërthehen nga përkufizimet e mësipërme dhe në përgjithësi nuk do t’u shërbejnë as analizave tona të incidenteve të kërcënimit. Gjithashtu, kemi bërë disa modifikime të mëdha për shkak se kemi shtuar shumë incidente në databazën tonë, krahasuar me atë që GTD ka ofruar në databazën e vet për Kosovën. Kemi identifikuar incidentet shtesë të kërcënimit duke shfrytëzuar burimet e mëposhtme shtesë: të gjitha Raportet Vjetore të Departamentit të Shtetit të SHBA-së mbi Terrorizmin; të gjitha raportet vjetore të Policisë së Kosovës; të gjitha numrat e revistës së Policisë së Kosovës “Mbrojtësi”, që botohet here pas here (e disa ofrohen për publik); të gjitha raportet vjetore të EUROPOL-it; si dhe mediat kombëtare dhe ndërkombëtare që mund të kenë raportuar për incidente të ndryshme. Ne jemi të vetëdijshëm se mund të ketë një ose tjetër incident kërcërimi që mund të mos jetë përfshirë në databazë. Kjo mund të ndodhë me ato kërcënimet që nuk kanë figuruar në burimet e shtuara më sipër. Përkundër kësaj, ne besojmë se një pavëmendje e tillë është minimale duke pasur parasysh përmasën e vogël të Kosovës në aspektin e territorit dhe popullsisë, dhe çfarëdo lëshimi i lehtë potencial në këtë drejtim megjithatë nuk do të ndryshojë konkluzionet tona të përgjithshme dhe gjetjet në këtë raport.

22 Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START), “Global Terrorism Database (GTD) Codebook: Inclusion Criteria and Variables,” 2017, <https://www.start.umd.edu/gtd/about/>).

23 Për më shumë detaje mbi terrorizmin në GTD, shih: Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START).

24 Për më shumë shih: Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (START), “Databaza e Terrorizmit Global (GTD),” 2017, <https://www.start.umd.edu/gtd/about/>.

3. PËRMBLEDHJE E INCIDENTEVE TË KËRCËNIMIT

Gjatë rreth një dekade, ndërmjet shkurtit 2008 dhe qershorit 2017, QKSS ka regjistruar 73 incidente të kërcënimeve, të cilat përbëjnë më pak se 8 incidente kërcënimi në vit. Këto incidente mund të ndahen më tej në dy lloje më të gjera, përkatësisht incidente me kërcënime të natyrës politike dhe fetare. Nga 73 incidentet e kërcënimit, afërsisht 62 për qind, ose 45 prej tyre kanë qenë politike, rreth 36 për qind, ose 26 kanë qenë fetare, ndërsa dy kërcënime të tjera mbeten të panjohura për sa i përket motivit dhe qëllimit të tyre. Kjo do të thotë se ka pasur diku më pak se 5 incidente të kërcënimeve politike në vit (mesatarisht) dhe më pak se 3 incidente të kërcënimeve fetare në vit (mesatarisht) gjatë periudhës së analizuar.

Me përjashtim të vitit 2009, kur u regjistruan gjithsej vetëm 3 incidente, në të gjitha vitet e tjera, incidentet e kërcënimit politik përbënin pjesën më të madhe të incidenteve të kërcënimit në krahasim me totalin. Gjatë këtyre viteve, bëhet e qartë se qysh nga dalja e Daeshit në vitin 2014 dhe shfaqja e fenomenit të luftëtarëve të huaj, incidentet e kërcënimit me bazë fetare marrin pjesë më të madhe krahasuar me vitet e kaluara; megjithatë, pavarësisht kësaj, këto incidente mbesin të nënpërfaqësuar krahasuar me incidentet e kërcënimeve të motivuara politikisht. Siç tregohet në figurën 1, midis viteve 2011 dhe 2016, incidentet e kërcënimeve politike shkojnë mbi 50 përqind të incidenteve të përgjithshme kërcënuese të regjistruara për çdo vit. Dy kërcënimet të cilat nuk mund të kategorizohen as si politike e as si fetare, përfshijnë një incident që ndodhi në Festivalin e BIRRËS në Gusht të vitit 2016 në Prishtinë, ku thuhet se kishte një të shtënë arme zjarri dhe kjo u mor gabimisht si një akt terrorist nga turma që po qëndronte aty. Ky incident shkaktoi rreth 40 lëndime nga ikja në rrëmujë e sipër që pasoi.²⁵


Incidenti tjetër që nuk mund ta klasifikojmë është ai që ka rrjedhur nga deklarata e paqartë e lëshuar nga Këshilli i Sigurisë i Kosovës, i përmendur edhe në hyrjen e këtij raporti. Ky kërcënim mbetet i mjegullt për shkak se u referohet në mënyrë të paqartë caqeve të ndryshme shtetërore dhe joshtetërore. Deklarata e Këshillit të Sigurisë së Kosovës u lëshua në prill 2017, në një kohë kur u zhvilluan ngjarje të shumta. Gjatë kësaj periudhe, Prokurori Special i Malit të Zi publikoi akuzat dhe dëshmitë kundër atyre (që dyshohet se janë ndikuar nga Rusia) që janë përpjekur të përmbysin qeverinë në Malin e Zi në vitin 2016.²⁶ Në të njëjtën kohë, Policia Serbe arrestoi një numër të

25 Kara O'Neill, "Mbi 40 vetë të lënduar në stampedon në festivalin e birrës pasi që dikush thirri ISIS," *Mirror*, 2 gusht 2016, <http://www.mirror.co.uk/news/world-news/terrifying-scenes-40-people-injured-8543905>.

26 Ed Adamczyk, "14 të paditur për komplotin e grushtshtetit në Malin e Zi," *UPI*, 14 prill 2017, https://www.upi.com/Top_News/World-News/2017/04/14/14-indicted-in-Montenegro-coup-attempt-plot/6681492172477/.

qytetarëve serbë në Serbi, nga Veliko Gradishte dhe Zrenjanini, të dyshuar për përgatitjen dhe shitjen e materialeve kimike (armëve) për xhihadistët në Siri me pretendimin se i transportonin ato përmes Kosovës.²⁷ Po ashtu, Policia e Kosovës ndaloi një person në Pejë, i cili postoi një video në Youtube që shfaqte po atë individ duke kënduar këngë në mbështetje të xhihadit.²⁸ Ne nuk pretendojmë që paralajmërimi publik i Këshillit të Sigurimit të Kosovës është lëshuar si rezultat i këtyre ngjarjeve, por këto ngjarje të shumfishta brenda po asaj periudhe të shkurtër tregojnë për kontekstin në të cilin është lëshuar një deklaratë e tillë.

Figura 1: Lloje kërcënimesh lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73




Sa i përket fushëveprimit, incidentet e kërcënimit lidhur me Kosovën mbeten kryesisht vendore, ndonëse disa prej tyre gjithashtu përfshijnë një dimension ndërkombëtar. Nga 73 raste të incidenteve totale të kërcënimeve, 55 prej tyre, ose 75 për qind e totalit kanë pasur një fushëveprimtari të brendshme, ndërsa 18 të tjera, ose 25 për qind, kanë pasur një dimension ndërkombëtar. Këtu termi *vendor/brendshëm* u referohet incidenteve të kërcënimit që kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës, ndërsa *ndërkombëtar/jashtëm* u referohet incidenteve dalëse të kërcënimit, që do të thotë se incidenti ka lindur nga një individ i lidhur me Kosovën, i cili ka kërcënuar një entitet jashtë territorit të Kosovës. Dimensionin ndërkombëtar gjithashtu u referohet incidenteve të kërcënimeve hyrëse, që do të thotë se incidenti ka origjinën nga jashtë, duke kërcënuar subjektet brenda territorit të Kosovës. Shembulli në fjalë është ai i përmendur më parë, ku armët kimike të prodhuara në Serbi thuhet se janë duke u transportuar përmes Kosovës. Është interesante të theksohet se ndërsa incidentet politike të kërcënimit paraqesin

27 Gazeta Metro, "Serbët Që u Shisnin Armë Kimike Xhihadistëve, Përmes Kosovës," *Gazeta METRO*, 14 prill 2017, <http://gazetametro.net/serbet-qe-u-shisnin-arme-kimike-xhihadisteve-permes-kosoves/>.

28 GazetaExpress, "Gjuriq: Serbia Do Të Vazhdojë Projektet Në Kosovë," 20 shtator 2016, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/gjuriq-serbia-do-te-vazhdoje-projektet-ne-kosove-254911/>.

shumicën e kërcënimeve në Kosovë në dekadën e fundit, shumica, ose 58 përqind e incidenteve të lidhura me kërcënimet fetare në Kosovë kanë qenë të fushëveprimit ndërkombëtar, ndërsa 42 përqind e tyre kanë mbetur të brendshme, siç tregohet në Figurën 2. Përndryshe, shumica dërrmuese e incidenteve të kërcënimeve politike, ose rreth 93 përqind e tyre kanë mbetur të brendshme. Një analizë më e thellë e asaj çfarë një ndarje e tillë përfshin në lidhje me besueshmërinë e kërcënimeve, caqet e përfshira dhe pasojat, do të ofrohet në seksionet e mëvonshme të këtij raporti.

Figura 2: Fushëveprimi i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73



Ndonëse mbetet përtej qëllimeve të këtij raporti që të elaborojë arsyet ose shkaqet që qëndrojnë pas marrëdhënies së kundërt midis llojeve politike dhe fetare të incidenteve të kërcënimit nga njëra anë dhe fushëveprimit të tyre vendas dhe ndërkombëtar në anën tjetër, ia vlen të paraqiten disa vëzhgime këtu. Shumica e incidenteve të kërcënimeve fetare të fushës ndërkombëtare në vendet perëndimore kanë përfshirë individë që kanë të bëjnë disi me Kosovës e që nuk janë domosdoshmërisht të lidhur fort me Kosovën, e që përfaqësojnë brezin e ri të migrantëve që kanë lënë Kosovën në moshë të re me prindërit e tyre gjatë konflikteve të viteve 1990 në Ballkan. Një shembull i tillë është ai që përfshin dy vëllezër, Hysen Sherifi (29 vjeç në kohën e paraburgimit) dhe Shkumbin Sherifi

(23 në kohën e paraburgimit), të cilët janë dënuar nga gjykata federale e Qarkut Lindor të Karolinës së Veriut në SHBA për komplotin që t'ua heqnin kokat agjentëve federalë dhe dëshmitarëve (kjo përfshin Hysen Sherifin - vëllain më të vjetër).²⁹ Hysen Sherifi lëshoi kërcënime të tilla nga qelia e burgut, ndërsa përfshiu vëllain e tij (Shkumbinin) në planifikimin e komplotit, së bashku me individë të tjerë. Të dy vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes emigruan në SHBA gjatë viteve 1990 kur këta djem ishin në një moshë shumë të re.³⁰ Një

29 SHBA, Departamenti i Drejtësisë, "Terroristi i dënuar dënohet me burgim të përjetshëm për shkak të komplotit për të vrarë dëshmitarë në gjyqin e tij për terrorizëm," 13 maj 2013, <https://www.justice.gov/opa/pr/convicted-terrorist-sentenced-life-prison-plotting-kill-witnesses-his-terrorism-trial>.

30 Daily Mail, "Komplotuesi i dënuar terrorist në SHBA, sa ishte në burg porositi vrasës me pagesë për t'ua hequr kokën dëshmitarëve për \$5,000 për kokë," *Mail Online*, 26 janar 2012, <http://www.dailymail.co.uk/news/article-2092141/Hysen-Sherifi-US-terrorist-plotter-commissioned-hit-men-behead-witnesses-prison.html>; Për më shumë detaje mbi rastin, shih: CI CENTRE, "Domestic Terrorism Case: Hysen Sherifi," *The Centre for Counterintelligence and Security Studies* (blog), qasja më 23 tetor 2017, http://www.cicentre.com/?SHERIFI_Hysen.

shembull tjetër i ngjashëm është edhe rasti i Arid Ukës, i cili ka qëlluar dy ushtarë amerikanë në aeroportin e Frankfurtit, në vitin 2011. Arid Uka, nga një familje që kishte migruar në Gjermani rreth dyzet vjet më parë, ka lindur në vitin 1990.³¹ Ky është një shembull tjetër tipik i një sulmuesi që ka të bëjë disi me Kosovën, por jo të rritur në Kosovë, të përfshirë në një incident me kërcënim të një fushëveprimi ndërkombëtar. Këta janë disa shembuj tipikë, edhe pse jo të vetëm, të individëve të lidhur (dobët) me Kosovën, të përfshirë në incidente të kërcënimeve jashtë vendit.

Incidentet e tjera të kërcënimit në fushëveprimin ndërkombëtar, që përfshijnë individë të lidhur me Kosovën janë ato më të rejtat, që përfshijnë luftëtarë të huaj në vendet joperëndimore. Disa nga rastet përfshijnë atë ku një individ nga Kosova ishte përfshirë në një përleshje të armatosur në provincën Nigde në Turqi në mars të vitit 2012, ku tre persona mbetën të vdekur, ndër të cilët kishte ushtarë turq dhe oficerë policie.³² Një tjetër rast përfshin atë të Blerim Hetës, i cili në mars 2014 vrau rreth 50 vetë duke hedhur veten në ajër në Bagdad, Irak.³³ Në përmbledhje, shumica e incidenteve të lidhura me kërcënimet fetare në Kosovë janë të fushëveprimit ndërkombëtar (krahasuar me fushëveprimin e tyre të brendshëm) dhe përfshijnë individë të rinj. Në rastin e individëve të përfshirë në incidentet e kërcënimit në vendet perëndimore, duket se ata kanë lidhje më të dobëta me Kosovën - ata kanë lindur jashtë Kosovës ose kanë migruar në një moshë shumë të re. Për referencë, shembuj të tjerë janë të gjithë të renditur në databazën e kërcënimeve të QKSS, të dhëna si një aneks online të këtij dokumenti.

Së fundmi, në këtë pasqyrë, ne e konsiderojmë të vlefshme të paraqesim disa analiza ndërshtetërore nga Indeksi i Terrorizmit Global (GDI), i cili bazon ngjarjet e tij në Databazën e Terrorizmit Global (GTD). Si i tillë, u bëjmë thirrje lexuesve të jenë të kujdesshëm në këtë lloj krahasimi, siç kemi treguar tashmë se GTD, në rastin e Kosovës, ka nevojë për një përditësim. Një aspekt tjetër i këtyre treguesve që na bën të bëjmë thirrje për kujdes, është se ata janë kontekstualisht të pandjeshëm. Sidoqoftë, për qëllimet e kësaj pasqyre ende e konsiderojmë të vlefshme që të paraqesim pozitën e Kosovës midis vendeve të tjera (kryesisht) perëndimore në Indeksin e Terrorizmit Global.

31 Allan Hall, "Kjo është veshja ime e preferuar për vrasës': Fytyra e muslimanit kosovar që vrau dy pilotë amerikanë në Aeroportin e Frankfurtit," *Mail Online*, 3 mars 2011, <http://www.dailymail.co.uk/news/article-1362463/Arid-Uka-Face-Kosovan-Muslim-shot-dead-U-S-airmen-Frankfurt-airport.html>.

32 Besar Likmeta, "Turqia arreston shqiptarët pas sulmit të 'terrorit': Balkan Insight," *Balkan Insight*, 21 mars 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/three-albanians-arrested-in-turkey-terror-attack>.

33 Linda Pressly, "Djaloshi nga Kosova që u rrit për t'u bërë sulmues vetëvrasës," *BBC News* (blog), 8 tetor 2014, <http://www.bbc.com/news/magazine-29524402>.

Tabela 1: Ranglista e vendeve bazuar në databazën e Indeksit Global të Terrorizmit (Global Terrorism Index - GTI)³⁴

Rangu	Vendi	2014	2015	2016	3 year average
1	Turqia	5.980	5.737	6.738	6.152
2	Rusia	6.760	6.207	5.430	6.132
3	MB	5.170	5.613	5.080	5.288
4	SHBA	4.710	4.613	4.877	4.733
5	Franca	2.670	4.553	5.603	4.275
6	Irlanda	3.090	3.663	3.429	3.394
7	Gjermania	1.020	3.442	4.308	2.923
8	Norvegjia	3.570	2.738	2.077	2.795
9	Italia	2.550	3.364	2.363	2.759
10	Suedia	1.070	3.083	3.984	2.712
11	Kosova	2.730	3.018	2.205	2.651
12	Spanja	1.840	2.622	1.203	1.888
13	Maqedonia	1.450	2.252	1.860	1.854
14	Bosnja	0.760	1.516	2.675	1.650
15	Belgjika	0.530	1.977	1.245	1.251
16	Shqipëria	0.190	2.116	1.103	1.136
17	Zvicra	1.340	1.342	0.288	0.990
18	Austria	0.240	2.088	0.182	0.837
19	Danimarka	0.190	0.090	2.152	0.811
20	Finlanda	0.000	0.000	2.377	0.792
21	Holanda	0.580	0.429	0.864	0.624
22	Serbia	0.580	0.410	0.086	0.359

Siç mund të vërehet në Tabelën 1, indeksi mesatar trevjeçar i terrorizmit global (2014-2016) e rendit Kosovën në vendin e 11-të, në listën e 22 vendeve nën analizë. Pikët në Tabelën 1 paraqesin një llogaritje më komplekse të kombinimit të katër faktorëve sin ë vijim: (i) numri i përgjithshëm i incidenteve terroriste në një vit të dhënë; (ii) numri i përgjithshëm i fataliteteve të shkaktuara nga terroristët në një vit të dhënë; (iii) numri i përgjithshëm i lëndimeve të shkaktuara nga terroristët në një vit të dhënë; dhe (iv) një masë e dëmit total të pronës nga incidentet terroriste në një vit të dhënë. Ne fuqimisht inkurajojmë lexuesit e interesuar që të konsultohen me përshkrimin më të thellë të këtyre treguesve në vetë raportet e GTI-së. Bazuar në këta tregues, Tabela 1 tregon se Kosova renditet më ulët në indeksin e terrorizmit (kërcënim më i ulët), sesa vendet evropiane si Norvegjia, Gjermania, Suedia, Italia, Mbretëria e Bashkuar, apo të tjera si ShBA dhe Turqia. Në të njëjtën kohë, renditet më lart (megjithëse me margjina më të ulta) sesa vendet e tjera të Ballkanit, si Serbia, Bosnja, Shqipëria dhe disa vende të tjera evropiane.

34 Treguesit Global të Terrorizmit nga viti 2014, 2015 dhe 2016, raportet nga: Vision of Humanity, "Terrorism Index," *Vision of Humanity* (blog), qasur më 23 tetor 2017, <http://visionofhumanity.org/indexes/terrorism-index/>.

4. BESUESHMËRIA E KËRCËNIMEVE

Jo të gjitha incidentet e kërcënimit në dekadën e fundit kanë pasur të njëjtin status besueshmërie - meqë jo të gjithë janë ekzekutuar dhe jo të gjithë të paekzekutuara kanë pasur të njëjtën peshë sa i përket shkallëve të seriozitetit të tyre nëse do të ekzekutoheshin. Shumica e incidenteve të kërcënimit, ose 44 nga 73, u ekzekutuan dhe 29 të tjerat kanë mbetur të paekzekutuara. Megjithatë, incidentet e kërcënimit politik kanë pasur një shkallë shumë më të lartë të ekzekutimit sesa incidentet e kërcënimeve fetare. Po të krahasojmë përmes statusit të ekzekutimit, 78 përqind e kërcënimeve të ekzekutuara kanë qenë politike, ndërkaq 31 përqind kanë qenë fetare, siç tregohet në Figurën 3. Nëse e vëmë këtë në mesatare vjetore në raport me numrin e përgjithshëm të kërcënimeve, ka pasur më pak se 4 kërcënime politike të kryera në vit dhe më pak se 1 kërcënime fetare të kryera në vit.

Për më tepër, jo të gjitha kërcënimet e paekzekutuara kanë pasur të njëjtën karakteristikë të mosekzekutimit. Për shembull, nga pjesa e 22 për qind e incidenteve të paekzekutuara të kërcënimeve politike, 11 për qind dështuan të ekzekutohen, vetëm dy për qind u parandaluan, ndërsa 9 për qind të kërcënimeve të tjera, të paekzekutuara politike mbetën në nivelin e paralajmërimit ose dekretit të lëshuar nga grupe të panjohura ose individë. Për shembull, një kërcënim politik i dështuar ishte ai kur në shtator 2008, një grup i armatosur i njerëzve që mbanin simbolet e AKSh (Armata Kombëtare Shqiptare) ndaloi një autobus që bartte punonjësit e KEK-ut (Korparata Energjetike e Kosovës) dhe kërkoi të kontrollonte ID-të e tyre.³⁵ Ne e regjistruam këtë dhe incidente të tjera të ngjashme si "i dështuar", sepse autorët nuk kanë shkaktuar asnjë dëm ose nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim që mund të ketë çuar në një rezultat për të cilin kërcënim i do të konsiderohej i ekzekutuar. Ato kërcënime politike të regjistruara me statusin "paralajmërues" janë ato që kanë përfshirë, për shembull, AKSh që lëshon deklarata paralajmëruese për elitën politike për të hedhur poshtë Marrëveshjen e Brukselit apo kërcënimet e tyre paralajmëruese të lëshuara për deputetët e Kosovës që të mos votojnë për marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.³⁶

Në anën tjetër, nga pjesa e 69 për qind të incidenteve të kërcënimeve fetare që mbetën të paekzekutuara, 4 për qind e këtyre kërcënimeve dështuan të ekzekutoheshin, 50 për qind e tyre u parandaluan nga autoritetet, ndërsa 15 për qind mbetën në nivelin e një paralajmërimi ose dekreti të lëshuar nga grupe ose individë të njohur a të panjohur. Prandaj, duket se organet e sigurisë në Kosovë ishin shumë më të shpejta në parandalimin e kërcënimeve fetare, ndërkohë që dështuan ta bënë këtë në lidhje me incidentet e kërcënimit

35 SHBA, Departamenti i Shtetit, "Raportet e Vendeve mbi Terrorizmin 2008" (Washington, D.C.: United States Department of State, prill 2009), <https://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2008/>.

36 MalishevaPress, "AKSH Kërcënon Qeverinë, Urdhëron Mustafën e Thaçin t'i Tërheqin Nënshkrimet Nga Marrëveshja e Brukselit (Dokument)," 9 shtator 2015, <http://malishevapress.com/aksh-kercenon-qeverine-urdheron-mustafen-e-thacin-ti-terheqin-nenshkrimet-nga-marreveshja-e-brukselit-dokument/>; Lajmi.net, "Deputetët Që Do Të Votojnë pro Demarkacionit Tash i Kërcënon Edhe AKSH-Ja!" 26 gusht 2016, <http://lajmi.net/deputetet-qe-do-te-votojne-pro-demarkacionit-tash-i-kercenon-edhe-aksh-ja/>.

politik. Ka shumë shembuj të tillë që i kemi regjistruar në databazën tonë, por disa nga shembujt përfshijnë, për shembull, arrestimin e shtatë personave në Prishtinë dhe Gjilan, në nëntor 2013, të dyshuar për planifikimin e një sulmi terrorist në Kosovë.³⁷ Shembulli tjetër është ndalimi i pesë individëve pranë Liqenit të Badovcit, për të cilët autoritetet pretenduan se po planifikonin një komplot tjetër terrorist në Kosovë.³⁸ Ka shembuj të tjerë të ngjashëm në nivel vendor dhe ndërkombëtar, të cilët ne i kemi regjistruar në bazën tonë të të dhënave si “të parandaluar” nga autoritetet. Incidentet e kërcënimeve fetare të regjistruara me statusin e një “paralajmërimi” përfshijnë ato, për shembull, kur në nëntor 2014 mediat raportuan se Ebu Bekr Al-Bagdadi i Daeshit i dërgoi një letër kryeministrit të atëhershëm, Hashim Thaçi, duke kërcënuar Kosovën me sulme si hakmarrje ndaj arrestimit të muslimanëve në Kosovë.³⁹ Incident tjetër i kërcënimeve fetare, ndër të tjera, që mbart statusin e “paralajmërimit” përfshin videon 20 minutëshe ku xhihadistët ballkanikë, në mesin e të cilëve edhe disa luftëtarë të huaj të Kosovës, që lëshuan një paralajmërim kërcënues për popullin e Ballkanit, duke përfshirë Kosovën.⁴⁰

Figura 3: Statusi i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73





Figura 4: Statusi i detajuar i llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73



37 SHBA, Departamenti i Shtetit, “Raportet e Vendeve mbi Terrorizmin 2013” (Washington, D.C.: United States Department of State, prill 2014), <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/index.htm>.

38 2015 SHBA, Departamenti i Shtetit, “Raportet e Vendeve mbi Terrorizmin

39 SHBA, Departamenti i Shtetit, “Raportet e Vendeve mbi Terrorizmin 2015.”

40 Jihadology.net, “Al- ayāt Media Center Prezanton një video-mesazh të ri nga Shteti Islamik: ‘Nderi është në xhihad: mesazh për popujt e Ballkanit,’” 4 qershor 2015, <http://jihadology.net/2015/06/04/al-%e1%b8%a5ayat-media-center-presents-a-new-video-message-from-the-islamic-state-honor-is-in-jihad-a-message-to-the-people-of-the-balkans/>.

Kur të shqyrtohet statusi i (mos)ekzekutimit të incidenteve të kërcënimit sipas fushëveprimit të tyre (vendor/ ndërkombëtar), është e qartë se shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimit politik në vend është shumë më e lartë se norma totale e ekzekutimit e diskutuar më lart, shkalla e incidenteve të kërcënimeve fetare në vend mbetet shumë më e ulët se norma totale e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve fetare. Shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve politike në fushëveprimin e brendshëm ka qenë 81 për qind, ndërsa shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve fetare në vend ka mbetur në vetëm 18 për qind. Kjo prirje përmbysset kur shqyrtohen këto lloje të incidenteve të kërcënimit në fushëveprimin e tyre ndërkombëtar. Shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve politike në fushëveprimin ndërkombëtar, ka mbetur vetëm në 33 për qind, ndërsa ato të incidenteve të kërcënimeve fetare në fushëveprimin ndërkombëtar kanë mbetur në 40 për qind, që është shumë më e lartë se shkalla totale e ekzekutimit të incidenteve të të gjitha kërcënimeve fetare, ose ato të ekzekutuara në vend. Ne kërkojmë kujdes kur lexohen interpretimet tona në pikat e përqindjes këtu, veçanërisht incidentet e kërcënimit të fushëveprimit ndërkombëtar, sepse numri i tyre total (N) në përgjithësi mbetet shumë i ulët. Për shembull, në dekadën e fundit numri i përgjithshëm i incidenteve të kërcënimeve të ekzekutuara ndërkombëtare të llojeve fetare është 6, që do të thotë rreth 1 kërcënim fetar të ekzekutuar në çdo dy vjet.

Po ashtu, është interesante të shihet në Figurën 6, ku prezantojmë statusin dhe fushëveprimin e detajuar të llojeve të kërcënimeve në Kosovë, se shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve fetare në fushën ndërkombëtare është shumë më e lartë se norma e ekzekutimit të tyre në fushëveprimin vendor. Shtatëdhjetë e pesë për qind e incidenteve të kërcënimeve fetare të ekzekutuara janë ndërkombëtare në fushëveprimin e tyre, ndërsa 25 për qind janë vendore. Ndërsa në të njëjtën kohë, të gjitha incidentet e kërcënimeve të kryera përveç njërit nga ta, ose 97 për qind, kanë mbetur të fushëveprimit të brendshëm. Ekzekutimi i kërcënimit politik nga fushëveprimi ndërkombëtar, është rebelimi i majit të vitit 2015, të një grupi kosovar në Kumanovë, Maqedoni.⁴¹ Ndonëse shkalla e ekzekutimit të incidenteve të kërcënimeve fetare mbetet më e lartë në fushëveprimin ndërkombëtar sesa në atë vendor, është gjithashtu e qartë se shumica, ose 62 përqind e kërcënimeve të parandaluara fetare u parandaluan ndërkombëtarisht, ndërsa 38 përqind u parandaluan brenda vendit. Disa nga kërcënimet politike të dimensioneve ndërkombëtare që kanë mbetur të pa ekzekutuara dhe që mbajnë statusin e “paralajmërimit” përfshijnë disa kërcënime hyrëse ndërkombëtare të tipit politik të lëshuar nga Irinej, Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe, i cili në disa raste, si ato të nëntorit 2015 dhe të tetorit 2016, u bëri thirrje serbëve të Kosovës të përdorin forcën kundër Kosovës, nëse kjo e fundit do të bëhej anëtare e

41 Fatjona Mejdini, “Shkëmbimi i zjarrit në Kumanovë të Maqedonisë ende ngre dyshime,” *Balkan Insight*, 10 maj 2016, <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-s-kumanovo-shootout-still-raising-suspicious-05-10-2016>.

UNESCO-s ose për arsye të tjera.⁴² Përkundër faktit se kërcënime të tilla vijnë nga një autoritet fetar jashtë Kosovës, ne i kemi regjistruar ato si incidente të kërcënimit politik, duke qenë se Kisha Ortodokse Serbe dhe Shteti Serb janë shpesh dhe ndërsjellazi të përfshirë në hartimin e politikave shtetërore.

Figura 5: Statusi dhe fushëveprimtaria e llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73






Figura 6: Statusi dhe fushëveprimtaria e detajuar e llojeve të kërcënimit lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73




42 Sasa Dragojlo dhe Petrit Collaku, "Kërcënimi me forcë për Kosovën nga Patriarku Serb rrezikon stabilitetin," *Balkan Insight*, 4 nëntor 15, <http://www.balkaninsight.com/en/article/serbian-patriarch-war-call-threatens-region-stabilit-11-04-2015>; BlicOnline, "ONO ŠTO JE SILOM OTETO, SILOM SE I VRAĆA' Patrijarh Irinej: Nećemo Dozvoliti Da Kosovo Bude Izgubljeno," 11 tetor 2016, <http://www.blic.rs/vesti/drustvo/ono-sto-je-silom-oteto-silom-se-i-vraca-patrijarh-irinej-necemo-dozvoliti-da-kosovo-b3nesdf>.

Në fund, paraqesim shpërndarjen gjeografike të kërcënimeve bazuar në llojin e tyre (politik/fetar/të panjohur) dhe statusin e tyre (të ekzekutuar/të paekzekutuar), në hartat në vijim. Shumica e kërcënimeve politike që janë ekzekutuar bëhen më të qarta kur shikojmë Hartën 1, e cila paraqet të dhënat për Kosovën. Harta 1 tregon se shumica e incidenteve të kërcënimit politik (shumica e të cilave janë ekzekutuar), kanë ndodhur në pjesën veriore të Kosovës dhe disa në kryeqytetin e Prishtinës, ndërkohë që shumica e incidenteve të kërcënimeve fetare kanë mbetur të paekzekutuara dhe janë të shpërndarë nëpër pjesë të ndryshme të Kosovës. Hartat tjera në vijim, domethënë, Harta 2, Harta 3, dhe Harta 4 tregojnë shpërndarjen gjeografike të incidenteve të tilla kërcënuese në mbarë botën. Për shembull, në Hartë 4 (Azia Juglindore) ekziston një kërcënim i vetëm fetar i ekzekutuar, i cili është i regjistruar si rezultat i hakerit kompjuterik me origjinë nga Kosova, i cili ka hyrë në sistemin e administratës amerikane dhe ka dorëzuar materialin në Daesh në shtator 2015. Kur të përmendet ky lloj kërcërimi, gjithashtu bëhet e qartë se jo të gjitha incidentet e kërcënimit që janë ekzekutuar janë të njëjta në llojin dhe pasojat e tyre, gjë që na çon në pjesën tjetër të raportit, ku diskutojmë pasojat e të gjitha këtyre incidenteve kërcënuese sipas llojit, statusit dhe fushëveprimit të tyre.


Harta 1: Lloji dhe statusi i kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73



Harta 2: Evropa dhe Lindja e Mesme, N=70



Harta 3: Amerika Veriore, N=2



Harta 4: Azia Juglindore, N=1

■ Politike ■ Fetare ■ Panjohura × Të ekzekutuara • Të pækzekutuara



5. PASOJAT

Ashtu sikur treguam në pjesën e mëparshme se jo të gjitha kërcënimet janë të njëjta për sa i përket besueshmërisë, pasi që disa prej tyre janë ekzekutuar ndërsa shumë të tjera kanë mbetur të paekzekutuara, incidentet e kërcënimit në Kosovë ndryshojnë gjithashtu edhe në aspektin e pasojave të tyre. Disa prej tyre rezultuan me vdekje, disa me lëndime, ndërsa shumica e këtyre kërcënimeve nuk kishin viktima. Nga gjithsejt 73 kërcënime të regjistruara, 52 ose 71 për qind e tyre nuk rezultuan me viktima, ndërsa vetëm 12 incidente të kërcënimit, ose 16 për qind rezultuan me vdekje dhe 8 prej tyre ose afër 11 për qind rezultuan me lëndime. Kjo do të thotë se mesatarisht, ka pasur (pak më shumë se) 1 kërcënim në vit që çoi në vdekje nga të gjitha kërcënimet e regjistruara pavarësisht nga lloji apo fushëveprimi. Prandaj, në total, kërcënimet në Kosovë kanë mbetur shumë të ulëta në vdekshmërinë e tyre, dhe shumica dërrmuese e tyre nuk shkaktuan viktima - as vdekje, as lëndime. Kjo flet për natyrën e incidenteve të lidhura me kërcënimin në Kosovë në dekadën e fundit - si kryesisht dhe mesatarisht jo të dëmshme fizikisht për individët apo objektet e tjera.


Kur flitet për pasojat sipas llojeve të tyre, shumica e incidenteve të kërcënimit që shkaktuan vdekjen mbesin politike. Për shembull, siç tregon Figura 7, 67 për qind e kërcënimeve që shkaktuan vdekjen ishin të natyrës politike, ndërsa 33 për qind e kërcënimeve që shkaktuan vdekjen ishin fetare. Për më tepër, asnjë tip fetar i incidentit të kërcënimit nuk shkaktoi lëndime, ndërsa 88 për qind e incidenteve të kërcënimeve të lidhura me lëndimet ishin të natyrës politike. Kur i vëmë këto në terma mesatarë, shohim se ka pasur më pak se 1 incident kërcënim politik që çoi në vdekje në një vit të dhënë dhe kishte më pak se 1 incident të kërcënimeve fetare që çoi në vdekje, në dy vjet.

Gjatë dekadës së kaluar, shumica e incidenteve të kërcënimeve politike që kanë rezultuar me vdekje kanë të bëjnë me pjesën veriore të Kosovës. Për shembull, në mars të vitit 2008, një ushtar ukrainas vdiq si rezultat i lëndimeve të pësuar nga një granatë dore që u hodh në përlëshjet në atë zonë të Kosovës.⁴³ Shembuj të tjerë të kërcënimeve të tilla që rezultojnë me vdekje që janë regjistruar në databazën tonë, ndër të tjera përfshijnë vrasjen e një oficeri të Policisë së Kosovës, në korrik 2011,⁴⁴ një qytetar, shqiptar etnik, që vdiq pasi një granatë u hodh në apartamentin e tij,⁴⁵ ose sulmi mbi EULEX-in që ndodhi në pjesën veriore të Kosovës ku një anëtar lituanëz i misionit gjeti

43 Fred Attewill dhe Ian Traynor, "Zyrtari policor i KB vdes pas përlëshjeve në Kosovë," *The Guardian*, 18 mars 2008, sec. World news, <http://www.theguardian.com/world/2008/mar/18/kosovo.serbia1>.

44 Freedom House, "Kosovo" (Washington, D.C.: Freedom House, 2012), <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2012/kosovo>.

45 ICG, "Ndjekja e konflikteve në mbarë botën" (International Crisis Group, 2012), <https://www.crisisgroup.org/crisiswatch/print?t=Crisiswatch+April+2012&crisiswatch=553&date=April+2012>.

Figura 7: Viktimat në kërcënimet lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73

vdekjen.⁴⁶ Llojet e tjera të ngjashme të kërcënimeve që kanë rezultuar me vdekje, plagosje, ose ku nuk ka pasur viktima, regjistrohen në databazën e QKSS dhënëve për incidentet e kërcënimit që është në dispozicion publik.


Gjithashtu kemi shqyrtuar shpërndarjen e viktimave për çdo lloj kërcënimi në bazë të fushëveprimit të tyre (vendor/ndërkombëtar). Siç shihet në Figurën 8, incidentet e kërcënimeve fetare të fushëveprimit vendor, nuk kanë rezultuar me vdekje apo lëndim. Të gjitha, ose totali prej 4 incidenteve të kërcënimeve fetare që rezultuan me vdekje, ishin të fushëveprimit ndërkombëtar. Këtu hyjnë incidentet më të fundit që përfshijnë konfliktin sirian, ku, për shembull, në mars të vitit 2014, Blerim Heta shpërtheu vetveten duke vrarë dhjetra vetë në Bagdad, apo rastin e marsit 2012, ku një individ nga Kosova ishte përfshirë në vrasjen e disa ushtarëve turq në Nigde, Turqi.⁴⁷ Në anën tjetër, 88 për qind e incidenteve të kërcënimeve politike që rezultuan me vdekje, ishin të fushëveprimit vendor. Të gjitha kërcënimet që shkaktuan lëndime, ishin vendore në fushëveprim dhe të natyrës politike. Të përmbledhura, prej 73 kërcënimeve të regjistruara, vetëm në 12 prej tyre ka pasur vdekje, nga të cilat 8 ishin të llojit politik (7 vendor dhe 1 ndërkombëtar), ndërsa 4 ishin të llojit fetar (të gjithë ndërkombëtar).

Deri më tani në këtë seksion, kemi diskutuar numrin e kërcënimeve dhe llojin dhe fushëveprimin e tyre, që kanë rezultuar me vdekje, lëndim ose pa viktima. Tash, të fil-

46 Balkan Insight, "Polici i EULEX-it qëllon për vdekje në Kosovën Veriore," *Balkan Insight*, 19 shtator 2013, <http://www.balkaninsight.com/en/article/eulex-attacked-in-north-kosovo>.

47 Pressly, "Djaloshi nga Kosova që u rrit për t'u bërë sulmues vetëvrasës"; Likmeta, "Turqia arreston shqiptarët pas sulmit të Terrorit"; *Balkan Insight*.


Figura 8: Viktimat sipas fushëveprimit të kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=73



lojmë diskutimin për numrin e viktimave, sipas llojeve të kërcënimeve dhe fushëveprimit të tyre. Incidentet e kërcënimeve që shkaktuan vdekjen janë të përziera. Derisa incidentet që shkaktuan vdekjen, janë të rralla, grafiku në Figurën 9 tregon se në fushëveprimin vendor, vdekja është shkaktuar vetëm nga disa kërcënime politike dhe numri i njerëzve që kanë vdekur në ato kërcënime ka mbetur i ultë- i treguar me x të kuqe në figurën 9. Kur është fjala për fushëveprimin ndërkombëtar, po ashtu, numri i kërcënimeve që kanë rezultuar me vdekje ka mbetur i ultë, por ka shkaktuar numër më të madh vdekjesh. Për shembull, incidenti politik në Maqedoni rezultoi me një shifër vdekjeprurëse prej afër 20 personash, ndërsa incidenti i kërcënimit fetar që shkaktoi vdekjen e më shumë se 50 personave, mbetet ai i shpërthimit vetëvrasës të ndërmarrë në Bagdad nga Blerim Heta, që kishte shkuar atje për të luftuar si një luftëtar i huaj.

Pavarësisht kësaj, numri mesatar i viktimave për kërcënim mbetet jashtëzakonisht i ultë. Ka dy mënyra për të parë këto mesatare. Një mënyrë është që të shikojmë numrin mesatar të viktimave kundrejt kërcënimeve totale të regjistruara në databazën tonë. Nëse e bëjmë këtë, atëherë numri mesatar i vdekjeve për kërcënim në dekadën e fundit është 1.26, ndërsa numri mesatar i lëndimeve për kërcënim në dekadën e fundit është 1.40. Kjo do të thotë se mesatarisht rreth 1 person vdiq dhe 1 u lëndua për çdo kërcënim gjatë dekadës së fundit. Nëse i shikojmë këto mesatare për vit, atëherë numrat shkojnë rreth 9 herë më të ulëta, pra afër 0.15 individë që vdiqën ose u lënduan në çdo vit. Tabela 2 tregon më shumë detaje në lidhje me këto mesatare, duke përfshirë numrat në lidhje me llojin dhe fushëveprimin e kërcënimeve.

Figura 9: Numri i viktimave sipas fushëveprimit të kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017)



Një tjetër mënyrë për të shikuar mesataret është që t'i shqyrtojmë ato jo kundër kërcënimeve totale, por vetëm kundër të gjitha viktimave që kanë shkaktuar kërcënimet. Nëse e bëjmë këtë, atëherë, siç tregon Tabela 3, numri mesatar i vdekjeve për kërcënime që shkaktojnë vdekje në dekadën e fundit është 9.20, që do të thotë që rreth një person vdiq në vit, në një kërcënim me vdekje. Po kështu, numri mesatar i individëve të dëmtuar për kërcënime që shkaktojnë lëndime në dekadën e fundit është 6.2, që do të thotë se rreth një person për çdo dy vjet është lënduar në kërcënime që shkaktojnë lëndime. Tabela 3 tregon më shumë detaje në lidhje me këto mesatare, duke përfshirë numrat në sipas llojit dhe fushëveprimit të kërcënimeve.

Tabela 2: Numri mesatar i viktimave të kërcënimit total lidhur me Kosovën, përgjatë viteve 2008-2017

Mesatarja/TOTALET	Politik		Religjioz		Total	
	Vdekje	Lëndim	Vdekje	Lëndim	Vdekje	Lëndim
Vendor	0.12	0.60	0.00	0.00	0.09	1.18
Ndërkombëtar	6.00	12.33	4.60	0.00	4.83	2.06
Total	0.51	1.38	2.65	0.00	1.26	1.40
Mesatarja vjetore	0.06	0.15	0.28	0.00	0.14	0.15

Tabela 3: Numri mesatar i viktimave që u shkaktuan nga kërcënimet lidhur me Kosovën përgjatë viteve 2008-2017


Mesatarja/BRENDA	Politik		Religjioz		Total	
	Vdekje	Lëndim	Vdekje	Lëndim	Vdekje	Lëndim
Vendor	1.00	2.78	0.00	0.00	1.00	2.78
Ndërkombëtar	18.00	37.00	17.25	0.00	17.4	37.00
Total	3.83	6.20	17.25	0.00	9.20	6.20
Mesatarja vjetore	0.41	0.67	1.85	0.00	0.99	0.67

Pjesa mbi pasojat e kërcënimeve do të mbetet i papërfunduar, në qoftë se nuk do të diskutonim caqet e çdo kërcënimi, pavarësisht nëse ato qenë ekzekutuar apo jo. Data-baza e QKSS-së tregon se afërsisht 40 për qind e incidenteve të kërcënimit politik kishin institucionet e shtetit të Kosovës si cak të tyre, rreth një e katërta e tyre kishin qytetarët privatë si si cak, 20 për qind kishin organizatat ndërkombëtare në Kosovë (dmth. KFOR dhe EULEX) si caqe të tyre, ndërsa 10 për qind e incidenteve të kërcënimeve politike kishin zonat e banimit si cak të tyre. Shumica e tyre lidhen me incidentet që ndodhën në pjesën veriore të Kosovës dhe disa të tjerë në kryeqytet. Në lidhje me caqet e incidenteve të kërcënimeve fetare, një numër i mirë i tyre, ose rreth 40 për qind, mbeten të panjohur. Afër 20 përqind e incidenteve të kërcënimeve fetare kishin si cak të tyre qytetarët privatë, që është 5 për qind më e ultë se incidentet e kërcënimeve politike, ndërsa 15 për qind e tyre kishin si cak një shtet të huaj. Këto të fundit lidhen kryesisht me disa incidente që ndodhën në Nigde (Turqi), në Bagdad (Irak), dhe të ngjashme. Për më tepër, 11 për qind ose gjithsej 3 incidente të lidhura me fe, kishin si cak xhamitë vendore. Një nga ato përfshinë incidentin e janarit 2016, kur një eksploziv u gjet në një xhami lokale në Drenas, por nuk u ekzekutua.⁴⁸ Një incident tjetër përfshinë edhe atë të gushtit 2016, kur një qytetar serb i cili ishte maskuar si imam, hyri në xhaminë e një fshati të Gjilanit dhe vandalizoi atë dhe tjetri, përfshiu një incident më të fundit në të cilin një serb tjetër sulmoi një xhami në Novobërdë, e cila xhami u vandalizua brenda.⁴⁹ Ne i këshillojmë lexuesit të konsultojnë Figurën 10, dhe për më shumë detaje ata duhet ta konsultojnë databazën e QKSS-së.

48 Klan Kosova, "Ekskluzive: Gjendet Eksploziv Te Xhamia Në Drenas," 29 janar 2016, <http://klankosova.tv/ekskluzive-gjendet-eksploziv-te-xhamia-ne-drenas/>.

49 T. Selimi, "Synon Ta Shkatërrojë Minaren e Xhamisë Në Velekincë, Veç Pse Kishte Shqiponjën Në Të," *Bota Sot*, 14 gusht 2016, <http://www.botasot.info/gjilani-kosova/565952/synon-ta-shkaterroje-minaren-e-xhamise-ne-velekince-vec-pse-kishte-shqiponjen-ne-te/>; GazetaExpress, "Serbi Demolon, Shkollën, Xhaminë Dhe Ambulancën Në Novobërdë (Foto)," *GazetaExpress*, 15 prill 2017, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/serbi-demolon-shkollen-xhamine-dhe-ambulancen-ne-novoberde-foto-o-357340/?archive=1>.


Figura 10: Caqet e kërcënimeve lidhur me Kosovën (2008-2017), N=88



6. KËRCËNIMET LIDHUR ME LUFTËTARËT E HUAJ

Shfaqja e fenomenit të luftëtarëve të huaj, në mënyrë të justifikuar ka ngritur shumë shqetësime në lidhje me kërcënimin potencial që secili nga të kthyerit ose të kthyerit potencial mund të paraqesë ndaj qaqeve të ndryshme në Kosovë, që mund të jenë institucionet shtetërore, qytetarët e saj privatë ose zonat e banimit. Megjithatë, databaza jonë tregon se shumë pak luftëtarë të huaj kanë qenë të përfshirë në ndonjë nga kërcënimet e regjistruara, ndërkohë që asnjë prej këtyre kërcënimeve në të cilat ata ishin përfshirë, nuk ishte ekzekutuar. Nga gjithsej 117 luftëtarë të huaj të kthyer, vetëm 5 prej tyre janë përfshirë në kërcënimet të mundshme, ndërsa shumica dërrmuese, ose 96 përqind e luftëtarëve të kthyer nuk figurojnë si pjesëmarrës në asnjë nga kërcënimet e regjistruara nga QKSS, siç tregohet në figurën 11.

Figure 11: Numri i LH të përfshirë në kërcënimin lidhur me Kosovën (2008-2017), N=117



Mund të ketë shumë interpretime për një numër kaq të ultë të përfshirjes në kërcënimet nga ana e luftëtarëve të huaj të kthyer. Megjithatë, dy nga to, ia vlen të mirren parasysh. Një interpretim i kuptueshëm i përfshirjes së tyre të ultë në kërcënimet, mund të jetë fakti që autoritetet e sigurisë të Kosovës kanë vepruar me shpejtësi në arrestimin e shumicës dërrmuese të të kthyerve, kur fillimisht kanë filluar të ndalojnë disa dhjetra të dyshuar, që nga vera e vitit 2014 dhe si rezultat i kanë mbajtur ata në vëzhgim. Ndonëse kjo mund të jetë një interpretim i besueshëm dhe ndoshta mund të jetë i vërtetë në disa aspekte, ai megjithatë nuk arrin të shpjegojë pse shumë nga të kthyerit që kanë qenë të lirë deri në verën e vitit 2014, nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim kërcënues kundër ndonjë caku. Para se të kryheshin bastisje të mëdha, kishte vetëm dy të kthyer të dyshuar që

janë arrestuar me disa të tjerë nën dyshimin e planifikimit të një komploti terrorist.⁵⁰ Kërcënimet e madhë të cilat u hodhën poshtë nga autoritetet kosovare dhe shqiptare ku 19 individë u arrestuan nën dyshimin e planifikimit të një sulmi të njëkohshëm në Shqipëri dhe Kosovë gjatë ndeshjes së futbollit Shqipëri-Izrael, vetëm një nga ta, rezultoi të kishte qenë në Siri më përpara.⁵¹ Interpretimi tjetër i arsyeshëm mund të jetë fakti se shumë nga të kthyerit,


50 SHBA, Departamenti i Shtetit, "Raportet e Vendeve mbi Terrorizmin 2013."

51 Fatjona Mejдини, "Albania Police Take No Chances With Israel Match," *Balkan Insight*, November 11, 2016, <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-unprecedented-security-measures-over-football-match-with-israel-11-11-2016>.

veçanërisht shumë nga ata që udhëtuan dhe u kthyen nga Siria para vitit 2014, thjesht nuk mund të paraqesin kërcënime tradicionale terroriste, ashtu si të tjerët që udhëtuan atje pasi Daesh u krijua, në mesin e vitit 2014. Kjo ndodh për arsye se, siç tregoi QKSS në raportin e vet të prillit të vitit 2015, shumë nga këta "udhëtarë" dhe të kthyer në fillim kanë shprehur keqardhjen për faktin se kanë shkuar atje dhe janë kthyer të zhgënjyer nga realiteti atje.⁵² Përndryshe, të paktën ne duhet të kishim parë shumë më tepër nga ta, të përfshirë në incidentet e kërcënimeve fetare para ndalimit të tyre dhe bastisjeve të verës 2014.

Përveç numrit të luftëtarit të huaj të kthyer, ne gjithashtu kemi parë numrin e kërcënimeve në të cilat janë përfshirë dhe nga 71 raste të kërcënimeve, luftëtarët e kthyer të huaj kanë qenë të përfshirë në vetëm 3 prej tyre, ose gjithsejt në rreth 4 për qind e tyre. Sikur u tregua edhe më parë në këtë tekst, asnjë nga këto kërcënime nuk u ekzekutua, sepse që të tri ato, ishin parandaluar. Gjithashtu, asnjë nga tri kërcënimet ku ata ishin të përfshirë, nuk kanë qenë të njëjta në besueshmërinë e tyre. Dy incidentet e kërcënimeve që ndodhën në vend, në të cilat u përfshinë luftëtarët e huaj të kthyer, përfshijnë ato për të cilat organet e sigurisë dhe mediat pohuan se po komplotonin për një sulm terrorist - prandaj kjo është vështirë të gjykohet në këtë kohë. Njëri nga rastet, është rasti i Liqenit të Badovcit, ku në mesin e 5 individëve të arrestuar, 2 duket se kanë qenë në Siri më parë dhe tjetri rast, është rasti i vitit 2013, në të cilin 7 persona u arrestuan në Prishtinë dhe Gjilan, dhe sikur në të parin, 2 nga ta kishin qenë të përfshirë në Siri. Kërcënimi më serioz në të cilin një luftëtar i vetëm i kthyer mori pjesë, ishte rasti i një sulmi që ishte planifikuar të ndodhte njëkohshëm në Kosovë dhe Shqipëri, gjatë ndeshjes së futbollit Shqipëri-Izrael në nëntor 2016 - por nga 19 të arrestuarit në rastin 18 nuk kishin qenë në Siri më parë. Prandaj, këto lloj kërcënimesh dhe të tjerat në të cilat nuk u përfshi asnjë luftëtar i huaj i kthyer flasin për kërcënime që paraqiten nga individë që kurrë nuk kanë qenë në Siri. Për këtë arsye, do të ishte e sigurt për ta përmbledhur këtë pjesë, duke deklaruar se lidhja e luftëtarëve të huaj të kthyer me kërcënimet në Kosovë mbetet shumë e dobët; megjithëse, ne përmbahemi të japim ndonjë deklaratë parashikuese për të ardhmen duke pasur informatat që i kemi aktualisht në dispozicion.

Figura 12: Numri i kërcënimeve të LH lidhur me Kosovën (2008-2017), N=71



52 Shpend Kursani, "Report Inquiring into the Causes and Consequences of Kosovo Citizens' Involvement as Foreign Fighters in Syria and Iraq," Policy Report, Occasional Paper (Prishtina, Kosovo: Kosovar Center for Security Studies, April 2015), http://www.qkss.org/repository/docs/Report_inquiring_into_the_causes_and_consequences_of_Kosovo_citizens_involvement_as_foreign_fighters_in_Syria_and_Iraq_307708.pdf.

7. PËRFUNDIM

Duke ndjekur një qasje që mund të përshtatet më së miri me një analizë të rreziqeve në kontekstin e Kosovës, QKSS krijoi një databazë për kërcënimet që mbulonin periudhën prej pothuajse një dekade, domethënë ndërmjet shkurtit 2008 dhe qershorit 2017. Është evidente që me shfaqjen e konfliktit sirian dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj, edhe incidentet e kërcënimeve fetare janë rritur paksa në krahasim me vitet e kaluara. Megjithatë, gjetjet e këtij vlerësimi sugjerojnë se incidentet e kërcënimeve politike vazhdojnë të zënë hisen më të madhe në tablon e të gjitha kërcënimeve në Kosovë. Për më shumë, gjatë kësaj periudhe, incidentet e kërcënimit politik kanë pasur një shkallë shumë më të lartë të ekzekutimit sesa incidentet e kërcënimeve fetare, të cilat kanë mbetur mjaft të ulta në aftësinë e tyre për t'u ekzekutuar. Kjo, ndodh pjesërisht për shkak se incidentet e kërcënimeve fetare janë parandaluar dhe pjesërisht për shkak se besueshmëria e tyre mbetet e diskutueshme, kur dihet se disa nga to mbeten në statusin e “paralajmërimit”.

Kur flitet për pasojat e secilit prej këtyre kërcënimeve, databaza jonë si dhe analiza tregojnë se në kërcënimet ku përfshihej vdekja, 70 përqind ishin të natyrës politike, ndërsa pjesa tjetër, rreth 30 për qind, ishin të natyrës fetare. Megjithatë, në total, numri i kërcënimeve në të cilat ka pasur vdekje është shumë i vogël, ose 12 nga 73 akuza të incidenteve kërcënuese. Gjithashtu, kemi shikuar numrin e viktimave të përfshira në 73 akuza kërcënimi në databazën tonë. Shikuar nga pikëpamja statistikore, numri i viktimave, si në aspektin e vdekjeve apo të lëndimeve, mbetet i parëndësishëm. Gjatë shqyrtimit të numrit mesatar të viktimave kundrejt numrit të përgjithshëm të kërcënimeve, shihet qartë se ka pasur 1 vdekje për çdo shtatë vjet, dhe po ashtu 1 të plagosur për çdo shtatë vjet. Gjatë shqyrtimit të numrit mesatar të viktimave ndaj numrit të kërcënimeve që shkaktojnë viktima, prapë bëhet e qartë se numri i viktimave mbetet shumë i ultë - rreth 1 vdekje në vit dhe rreth 1 të plagosur në vit. Nuk ka pasur vdekje ose lëndim nga incidentet e kërcënimeve fetare të regjistruar brenda vendit; ato ishin më të dukshme në dimensionin ndërkombëtar, megjithëse numrat vazhduan të mbeleshin të margjinalizuar.

Lidhja ndërmjet luftëtarëve të huaj të kthyer dhe kërcënimeve në Kosovë, mbetet shumë e dobët. Nga rreth 117 luftëtarë të huaj të kthyer, 5 nga ta janë përfshirë në kërcënime, të cilat kurrë nuk u ekzekutuan. Ndërsa, numri i përgjithshëm i kërcënimeve në të cilat këta pesë individë ishin përfshirë, ishte 3 nga 73 sish. Sidoqoftë, QKSS-ja përmbahet nga ndonjë pretendim parashikues lidhur me involvimet e ardhshme të mundshme, pasi që ekzistojnë shumë pak informata, për shembull, në lidhje me luftëtarët e huaj të burgosur dhe të dënuar, marrëdhëniet e tyre me këto vendime,

sjelljen e tyre brenda burgjeve dhe efektet e mundshme që këto mund të kenë pasur mbi ta në raport me shtetin, institucionet e tij dhe shoqërinë në përgjithësi.

Së fundi, një shqetësim i përbashkët që ngrihet në kontekstin e Kosovës është edhe ndikimi që incidentet e kërcënimeve fetare (sado të ulëta që mund të jenë në krahasim me kërcënimet e tjera), mund të kenë në rendin shoqëror dhe vlerat e përgjithshme që shteti dhe (qartazi) shoqëria e saj dëshiron t'i ruajë. Sipas analizës së këtij raporti, ne i konsiderojmë këto shqetësime si mjaft të ekzagjeruara dhe për këtë mbështetemi në dy aspekte. Së pari, asnjë nga incidentet e kërcënimeve fetare të regjistruara në dekadën e fundit, nuk ka pasur kapacitetin apo aftësinë për të përmbysur rendin shoqëror. Thënë ndryshe, kërcënimet e tilla kanë qenë jodomethënëse në aftësinë e tyre për ta bërë këtë. Sfidë më e madhe për rendin shoqëror (dhe kushtetues) të Kosovës erdhi kryesisht nga incidentet e kërcënimeve politike, pasi që shumë nga këto kërcënime kishin caqe të qarta (institucionet shtetërore) si dhe synime të qarta (marrëveshje me rendin shoqëror dhe kushtetues). Së dyti, kur flitet për kërcënimin ndaj vlerave shoqërore, ne konsiderojmë se termi “kërcënim ndaj vlerave” përdoret shpesh në mënyrë manipulative, për shkak se diskutimi i “kërcënimit ndaj vlerave” kërkon supozimin se vlerat janë të ngrira në kohë dhe në hapësirë – gjë që, në aspektin sociologjik, është një supozim radikalisht çorientues. Nocioni i vlerave dhe traditave është fluid dhe ai ndryshon në kohë dhe në hapësirë. Çfarëdo diskutimi që përipiqet të homogjenizojë këto nocione, e hap derën e manipulimit në diskutimin dhe debatin në lidhje me vetë kërcënimet.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

343.97(496.51)"2008/2017"

Kursani, Shpend

Kosovo Risk Assessment Report Since Independence

February 2008 – June 2017 / Shpend Kursani. – Prishtinë : KCSS, 2017. – 40 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN-978-9951-679-68-8

ISBN 978-9951-679-68-8



9 789951 679688

www.qkss.org